



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/ L-040, nenin 5.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe nenit 25.1 të Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës,

THËRRAS

Mbledhjen e XLVII-të (dyzet e shtatë - mandati VI) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **29 prill 2021, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës së Podujevës**, në orën **10;00**, me këtë:

1. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2020 në vitin 2021 dhe destinimin në kategori të caktuara buxhetore
2. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – mars 2021
3. Propozim vendimi për vënie në diskutim publik të propozim Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës
4. Propozim Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa tarifa dhe gjoba Komunale
- Propozim vendimi për diskutim publik
5. Propozim Rregullorja punës së Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit të Podujevës “Avdush Hasani”
- Propozim vendimi për diskutim publik
6. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare - *për subvencionimin e bashkëfinancimit të ndërtimit të shtëpive të banimit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit në Komunën e Podujevës, me Shoqatën Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”*
7. Propozim vendimi për lirim nga taksa komunale – *shfrytëzimi i hapësirave publike / tarracave pranë lokaleve të subjekteve afariste të gastronomisë dhe operatorët e transportit publik*
8. Plotësim ndryshimi i përbërjes së Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në “Lagjen e Dëshmorëve” në fshatin Balloc, i ngritur me Vendimin nr.prot.01-020/04-0026812/18 të datës 28 mars 2018
9. Të ndryshme

Mbledhja mbahet duke respektuar masat sipas vendimeve dhe akteve tjera të mjetra nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe rekomandimeve të IKSHPK lidhur me situatën nga Pandemia Covid-19

Nr. 01-060/03-0033528/21
Podujevë, 19 prill 2021

